

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6705  
E mërkurë, 14 shtator 2022  
çmimi 0.40 €

## Policia ushtarake gjermane trajnon policinë ushtarake të Kosovës



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# PRESIDENTJA E HUNGARISË: DO TË BËJMË ÇMOS QË KOSOVA TA MARRË LIBERALIZIMIN E VIZAVE



Presidentja e Hungarisë, Katalin Novak, gjatë vizitës në Prishtinë, ka theksuar se si shtet do të bëjnë çmos që Kosova ta marrë liberalizimin e vizave. "Ne do të bëjmë çdo gjë që kemi mundësi që Kosova ta

marrë liberalizimin e vizave", ka deklaruar presidentja e Hungarisë, Katalin Novak, në një konferencë të përbashkët për medie me presidenten Vjosa Osmani

## OPINION

KOSOVË, NGREHE ZËRIN! F. 6

Shkruan:  
Sali BISLIMI



## AKTUALE



NË HAGË NISIN DEKLARATAT PËRMBYLLËSE PËR RASTIN E MUSTAFËS F. 5

GRATË ZOTËROJNË VETËM 17 PËR QIND TË PRONËS NË KOSOVË F. 7

AAK-JA KËRKON TË VOTOHET LIGJI PËR PENSIONISTËT KONTRIBUTDHËNËS F. 6

## EKONOMI



BIZNESET TË NJOFTOHEN PËR RËNDËSINË E ARBITRAZHIT SI MEKANIZËM ALTERNATIV PËR ZGJIDHJE TË KONTESTEVE F. 8

RAFUNA INTERESOHET PËR INVESTIME NGA TAJVANI NË KOSOVË F. 8

## SPORT

SOT DERBI DRITA - GJILANI F. 10



## NUK KA PAJTIM NË MES TË QEVERISË DHE SBASHK-ut



KOSOVA DHE BE-ja NËN SHKRUAJNË MARRËVESHJEN IPA III NË VLERË MBI 63 MILIONË EURO F. 5

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## BE-ja kërkon nga Serbia të mos i madhërojë kriminelët e luftës



**BRUKSEL, 13 SHTATOR** - Bashkimi Evropian ua tërhoqi vërejtjen liderëve politikë dhe fetarë në Serbi që të mos i madhërojë, siç tha, kriminelët e luftës. Reagimi vjen pas lajmit se Kisha Ortodokse Serbe dekoroi Vojislav Sheshelin - i dënuar nga Tribunali i Hagës për krime të luftës në ish-Jugosllavi. "Përpyekjet për ta rishkruar historinë janë të papranueshme", tha zëdhënësjja e Komisionit Evropian, Ana Pisonero, për gazetaret në Bruksel. "Qëndrimi i BE-së është

i qartë. Nuk ka vend në Evropë për mohimin e gjenocidit, revizionizëm dhe madhërim të kriminelëve të luftës - gjëra që janë në kundërshtim me vlerat themelore evropiane", tha Pisonero. Ajo shtoi se nga udhëheqësit fetarë pritet që të punojnë drejt pajtimit dhe tejkallimit të ndasive nga e kaluara. "Prijësit fetarë dhe bashkësitë fetare kanë, po ashtu, përgjegjësi që të dëshmojnë lidhësitë në përpjekjet për tejkallimin e trashëgimisë së vështirë nga e

kaluara si dhe të ndërtojnë në mënyrë konstruktive mirëbesim të ndërsjellë, tolerancë dhe dialog", tha Pisonero. Sheshelit iu dha urdhri "Ipeshkvi i Shenjtë Mardari" nga një dioqezë e Kishës Ortodokse Serbe, e cila ka selinë në Çikago. Çmimi iu dorëzua të dielën nga peshkopi Irinej i Baçkës, njoftoi Partia Radikale Serbe e Sheshlit. Kjo është hera e tretë që Kisha Ortodokse Serbe i ndan çmime Sheshelit.

## Zelensky: Kemi rikthyer 6 000 kilometra katrorë territor të pushtuar

**KIEV, 13 SHTATOR** - Ushtria ukrainase ka rikthyer 6 000 kilometra katrorë territor të pushtuar nga forcat ruse që prej nisjes së kundëroffensivës në fillim të muajit shtator, tha presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, më 12 shtator. Ai i bëri thirrje Perëndimit të vendosë më shumë sanksione ndaj Rusisë dhe t'i përshpejtojë dërgesat e armëve për t'i lejuar trupat ukrainase ta konsolidojnë kontrollin mbi territorin e rifituar. "Që nga fillimi i shtatorit ushtarët tanë kanë çliruar tashmë 6 000 kilometra katrorë të territorit ukrainas në lindje dhe jug dhe ne po përparojmë edhe më shumë", tha Zelensky. Gjashtë mijë kilometra katrorë është pothuajse e barabartë me zonën e kombinuar të Bregut Perëndimor dhe Gazës. "Forconi sanksionet, nevojitet një paketë e tetë e sanksioneve të BE-së. Është e nevojshme të rritet ndihma për Ukrainën, para së gjithash, për ta përshpejtuar sigurimin e sistemeve të mbrojtjes ajrore për



vendin tonë", tha Zelensky. Një zyrtar i Rusisë në rajonin e Harkivit ka thënë më 12 shtator se forcat ruse janë në numër shumë

më të vogël në krahasim me ato ukrainase. Duke folur për mediumin shtetëror rus "Rossiya 24", Vitaly

Ganchev ka thënë se trupat ukrainase kanë fituar kontrollin e zotëruar nga Rusia në muajt e fundit dhe se "rreth 5 000 civilë"

janë evakuuar drejt Rusisë. Sipas tij, ushtria ukrainase është në numër shumë të madh në krahasim me forcat ruse.

## Qeveria hungareze ashpëron rregullat për abortin



Budapest, 13 shtator - Qeveria hungareze e krahut të djathtë ka lëshuar një dekret përmes të cilit kërkohet që mjekët t'ua tregojnë grave që duan të kryejnë abort, shenjat vitale të fetusit. Ky obligim paraqet ashpërim të rregullave relativisht liberale të abortit në Hungari. Dekreti thotë se personeli shëndetësor duhet t'u ofrojë grave shtatzëna "një tregues të qartë e të identifikueshëm të shenjave vitale të fetusit" përpara se të vazhdojnë çdo procedurë të abortit. Ky rregull hyn në fuqi më 15 shtator. Ministria e Brendshme e Hungarisë tha se "gati dy e tretave e hungarezëve e lidhin fillimin e jetës

së një fëmije me rrahjet e para të zemrës" dhe se pajisjet moderne mund t'i detektojnë rrahjet e zemrës së fetusit në fillim të shtatzënisë, gjë që mund t'u "japë informacion më të plotë grave shtatzëna". Ligjet e abortit në Hungari janë relativisht liberale dhe kanë mbetur pothuajse të pandryshuara qëkur aborti u lejua më 1953. Qeveria nacionaliste hungareze, e udhëhequr nga kryeministri Viktor Orban, e portretizon veten si kampione të vlerave të familjes tradicionale dhe ka ofruar shkurtime tatimore dhe subvencione për familjet që kanë shumë fëmijë, në përpjekje për ta

rritur nivelin e natalitetit. Qeveria, po ashtu, ka futur në Kushtetutën e vitit 2011 pjesën që "jeta e fetusit duhet të mbrohet nga ngizja", por sërish ka tentuar që t'i ashpërojë rregullat e abortit. Ligjvënësja hungareze nga një parti e krahut të djathtë, Dora Duro, shkroi në "Facebook" se partia e saj, "Atdheu Ynë", ka paraqitur këtë kërkesë të re, duke shtuar se qeveria ka miratuar këtë kërkesë për t'i detyruar shtatzënat që t'i dëgjojnë të rrahurat e zemrës së fetusit para se të kryejnë abort. "Ky është vendimi i parë pro jetës qëkur është miratuar aborti më 1956, duke thyer tabunë prej dekadash", ka shkruar ajo.

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

- Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
- ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
- Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere\_mm@hotmail.com & mm\_epokaere@yahoo.com



## Policia ushtarake gjermane trajnon policinë ushtarake të Kosovës

Prishtinë, 13 shtator - Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, Armend Mehaj, ka bërë me dije se policia ushtarake gjermane ka trajtuar policinë ushtarake të Kosovës në shkathtësitë e mbrojtjes së afërt. Mehaj në "Facebook" ka shkruar se ky trajnim është realizuar në vazhden e partneritetit të ngushtë dhe planit të bashkëpunimit bilateral ushtarak në mes

forcave të dy vendeve tona. "Policia ushtarake gjermane trajnon policinë tonë ushtarake në shkathtësitë e mbrojtjes së afërt. Trajnimi njëjavor u ka mundësuar policëve tanë ushtarakë që ta ngrehin nivelin e përgatitjes në taktikat dhe teknikat e mbrojtjes së afërt të personave shumë të rëndësishëm (VIP). Ky trajnim u realizua në vazhden e partneritetit të

ngushtë dhe planit të bashkëpunimit bilateral ushtarak në mes forcave të dy vendeve tona. Mirënjohje dhe falënderim i thellë për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Gjermanisë për gjithë mbështetjen e madhe në ngritjen dhe zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve operationale të FSK-së", ka shkruar Mehaj.



## Kosova dhe BE-ja nënshkruajnë marrëveshjen IPA III në vlerë mbi 63 milionë euro



Kosova dhe Bashkimi Evropian (BE) kanë nënshkruar marrëveshjen për programin e parë financiar vjetor IPA III, ku Kosova do të përfitojë 63.96 milionë euro. Këto mjete do të përdoren për ta rritur konkurrencën e sektorit agro-ushqimor të Kosovës dhe për të ndihmuar në arritjen e kriterëve ekonomike të anëtarësimit në BE

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Kosova dhe Bashkimi Evropian kanë nënshkruar të martën marrëveshjen e parë financiare vjetore në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit III (IPA III) me vlerë 63.96 milionë euro. Pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi

të Marrëveshjes Kornizë Financiare të Partneritetit ndërmjet BE-së dhe Kosovës, ky ishte një nga hapat e fundit zyrtar që mundëson disbursimin gradual të ndihmës financiare të BE-së për Kosovën sipas marrëveshjes kornizë të partneritetit IPA III që mbulon periudhën 2021-2027. Kuvendi i Kosovës, gjithashtu,

duhet ta ratifikojë marrëveshjen.

Përmes 14 programeve të njëpasnjëshme financiare vjetore nga viti 2007 deri në vitin 2020, në kuadër të IPA I dhe IPA II, BE-ja deri më tani i ka ofruar Kosovës 1.21 miliard euro ndihmë financiare. "63.96 milionë euro fillestare nga IPA III do të përdoren për ta rritur konkurrencën e sektorit agro-ushqimor të Kosovës dhe për të ndihmuar në arritjen e kriterëve ekonomike të anëtarësimit në BE. Financimi më tej do të drejtohet drejt përmirësimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe avancimit të barazisë gjinore si dhe përmirësimit të ofrimit të

shërbimeve komunale dhe sigurisë publike në Kosovë", ka theksuar ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog. Sipas tij, përveç kësaj, financimi i BE-së do të përdoret për ta përmirësuar mbrojtjen e mjedisit në Kosovë, në përputhje me praktikën më të mira të BE-së dhe për t'i forcuar kapacitetet e administratës së Kosovës për t'iu përbajtur standardeve të BE-së. Financimi vjetor IPA III do të kombinohet me 16 milionë euro shtesë nga Qeveria e Kosovës dhe financim nga partnerët e tjerë në shumën prej 3.8 milionë eurosh. "Sot do të fillojmë të përfitojmë konkretisht nga ndihma që BE-

ja i ofron Kosovës përmes fondeve IPA III. Marrëveshja e financimit për programin vjetor IPA 2021 është marrëveshja e parë për projektet në kuadër të fondeve IPA III dhe ne kemi besim se do të përdorim në maksimum të gjithë potencialin tonë për të përfituar nga IPA III, për t'i promovuar reformat dhe për t'i arritur standardet e nevojshme për ta sjellë Kosovën më afër BE-së", ka deklaruar zëvendëskryeministri i parë për Integritet Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi. BE-ja mbetet partnerja më e madhe tregtare e Kosovës dhe ofruesja më e madhe e ndihmës financiare.

## 100 000 amerikanë kanë vizituar Shqipërinë në periudhën janar-gusht

TRANË, 13 SHTATOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka njoftuar se rreth 100 000 vizitorë amerikanë kanë ardhur në Shqipëri në muajt janar-gusht. Në "Facebook", Rama ka shtuar

se numri i vizitorëve amerikanë është 28 mijë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. "527 turistë amerikanë kanë mbërritur këtë mëngjes në Portin e Durrësit me kroçierën 'Nautica', pjesë e turit të tyre në

portet e Adriatikut e Jonit. 100 000 vizitorë amerikanë kanë ardhur në Shqipëri në muajt janar-gusht, 28 mijë më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar", ka shkruar Rama.







# Presidentja e Hungarisë: Do të bëjmë çmos që Kosova ta marrë liberalizimin e vizave

Presidentja e Hungarisë, Katalin Novak, gjatë vizitës në Prishtinë, ka theksuar se si shtet do të bëjnë çmos që Kosova ta marrë liberalizimin e vizave. “Ne do të bëjmë çdo gjë që kemi mundësi që Kosova ta marrë liberalizimin e vizave”, ka deklaruar presidentja e Hungarisë, Katalin Novak, në një konferencë të përbashkët për medie me presidenten Vjosa Osmani

**EPOKA  
ERE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 13 SHTATOR** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën me nderime të larta shtetërore presidenten e Hungarisë, Katalin Novak. Osmani, pas takimit, në një konferencë të përbashkët për medie, ka theksuar se raportet e Kosovës me Hungarinë janë të ndërtuara mbi një bazament të fortë historik, të cilat Kosova është e përkushtuar t'i forcojë në

përfitim të qytetarëve tanë. “Prandaj ishte nder që bashkë me Prindonin ta mirëprisnim në Kosovë presidenten hungareze Katalin Novak së bashku me Zotërinë e Parë të Hungarisë, z. Veres Istvan Atta. Me presidenten hungareze, e cila po e viziton Kosovën në fillim të mandatit të saj, biseduam për nevojën e mbështetjes së ndërsjellë për kalimin e sfidave të përbashkëta si dhe avancimin e rrugës euroatlantike për vendin tonë. Ritheksa urgjencën që

Bashkimi Evropian të vendosë pro liberalizimit të vizave për Kosovën përgjatë Presidencës Çeke të Këshillit të BE-së, duke kërkuar kështu përkrahjen e vazhdueshme të Hungarisë”, ka thënë Osmani. Presidentja e Hungarisë ka theksuar se do të bëjnë çmos që Kosova ta marrë liberalizimin e vizave. “Ne do të bëjmë çdo gjë që kemi mundësi që Kosova ta marrë liberalizimin e vizave”, ka deklaruar presidentja e Hungarisë, Katalin Novak. Ajo ka thënë se vendi i saj do të luajë rol

aktiv për të siguruar paqe dhe se objektivi i tyre është stabiliteti, “ashtu që të mos ketë më luftë në Evropë”. “Kanë kaluar 20 vjet prej përfundimit të luftërave në Ballkan, nuk është edhe shumë larg, ndërsa tani kemi luftën në Ukrainë dhe është tejet me rëndësi që kjo luftë ta shmangë Evropën”, është shprehur presidentja e Hungarisë. Novak para vizitës në Prishtinë ka qëndruar në Bukuresht, Beograd dhe Zagreb. Gjatë samitit të Procesit Bërdo-Brioni, më 12 shtator, presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, i bëri thirrje Bashkimit Evropian që t'i ofrojë Kosovës liberalizimin e vizave. Sipas tij, kjo thirrje është edhe pjesë e konkluzioneve që u miratuan pas samitit të së hënës. Prej të gjitha vendeve të

Ballkanit Perëndimor, Kosova është e vetmja që nuk ka liberalizim vizash me BE-në. Kosovës i janë vendosur dhjetëra kritere, edhe shtesë, të cilat, sipas të dyja palëve, janë plotësuar. Megjithatë, nga viti 2018 shtetet e BE-së nuk kanë arritur pajtim për t'iu mundësuar kosovarëve lëvizje të lirë. Rezerva të mëdha kanë shprehur sidomos Franca dhe Holanda. Aktualisht Kosova ka vetëm Marrëveshje Stabilizim-Asociimi (MSA) të nënshkruar me BE-në. Kjo marrëveshje kontraktuale, e vetmja ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, është nënshkruar në vitin 2014, ndërsa ka hyrë në fuqi më 2016.



## Nuk ka pajtim mes qeverisë dhe SBASHK-ut



PRISHTINË, 13 QERSHOR - Kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar edhe nga ministri Hekuran Murati dhe Arbërie Nagavci, kanë pritur të martën në takim Këshillin Grevist të BSPK-së.

Edhe nga ky takim nuk pati pajtim mes palëve për t'u ndërprerë greva në arsim.

Pas takimit ka folur për medie kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili ka thënë se greva do të vazhdojë pasi, sipas tij, nuk pati

diçka konkrete sa i përket kërkesës prej 100 eurove. "Të dyja palët i kanë thënë mendimet dhe idetë e tyre. Ne si këshill grevist ia rikujtuam kryeministrit Kurtit kërkesat tona që tashmë i dini të gjithë, kurse ata u thirrën në pakon e tyre. Takimi ishte përmbajtësor, por për momentin nuk kemi ndryshime. Qeveria qëndron me pakon, ne qëndrojmë si zë grevist me kërkesat tona. Temë e nxehtë ishte pakoja, por ne insistuam që

shuma e përmendur nuk është pranuar nga asnjë grevistë, ne ishim të gatshëm që edhe këtu të bëjmë një kompromis, por qeveria mbeti në atë që ka prezantuar", ka deklaruar Jasharaj.

Edhe kryeministri Albin Kurti ka mbajtur një konferencë për medie pas takimit me përfaqësuesit e Këshillit Grevist të BSPK-së. Ai ka thënë se në Projektligjin për Pagat mësimdhënës do ta kenë koeficientin më të lartë

ndonjëherë.

Kurti u ka bërë thirrje mësimdhënësve që të kthehen në shkollë. "Në takim më është thënë, kryeministër, lëviz, mirëpo unë kam lëvizur të paktën dhjetë herë në drejtim të kërkesave dhe nevojave të sindikatave dhe punëtorëve të arsimit. Pikërisht për këtë arsye edhe një herë kërkoi që nxënësit të shkojnë në shkollë e mësimdhënësit të shkojnë në shkollë. Të parët të mësojnë e të

dytët të japin mësim. Nuk i bëhet bojkot dhe grevë shtetit", ka thënë Kurti, duke shtuar se nuk është e vërtetë që nuk ka pasur komunikim me Këshillin Grevist të BSPK-së.

Ai ka treguar se Këshillit Grevist ia ka paraqitur një ofertë të re. "Ne sot përfaqësuesve të Këshillit Grevist ua thamë edhe tri gjëra, për të cilat na premtuan se do ta pyesin anëtarësinë. Pra, neve na u tha në takim që për këtë ofertë të qeverisë do të pyetet anëtarësia. Por sapo dolën nga takimi u deklaruan për medie se greva vazhdon. Kur e pyetën anëtarësinë? Neve na thanë në takim se do ta pyesin anëtarësinë. Oferta shtesë ishte kjo: Do të jenë pjesë përmbajtësore e diskutimeve publike për Projektligjin mbi Pagat dhe ne atyre ua dhamë lajmin të parët se këtë javë do të fillojë diskutimi publik. Dy të tjerat ishin se bashkërisht me BSPK-në do ta bëjmë reformën e sistemit pensional në mënyrë që ta bëjmë diferencimin e kategorive të ndryshme duke e hequr atë pragun famëkeq prej 15 vjetësh përvojë pune. U zotuar që te barnat esenciale do të shtohen edhe 10 milionë euro. Ata thanë se do të konsultohen me anëtarësinë por, kur dolën nga takimi, thanë se vazhdon greva", ka thënë kryeministri Kurti.

## Në Hagë nisin deklaratat përmbyllëse për rastin e Mustafës

HAGË, 13 SHTATOR - Disa nga dëshmitarët në gjykimin e Salih Mustafës, ish-pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), konfirmuan qartë se ishin viktima, sepse pjesëtarët e UÇK-së i konsideronin "armiqtë të Kosovës apo spiunë", thuhet në deklaratën përmbyllëse të Prokurorisë së Specializuar të Kosovës në Hagë. Bëhet fjalë kryesisht për shqiptarë të Kosovës dhe prokurori Jack Smith shpjegoi se viktimat kanë kaluar nëpër agoni gjatë gjithë këtyre viteve, si dhe rikujtoi disa dëshmi në të cilat dëshmitarët kanë thënë se edhe sot "dëgjojnë zërat e njerëzve që i kanë torturuar".

Deklaratat përmbyllëse para Dhomave të Specializuara (Gjykata Speciale) në Hagë duhet të përfundojnë më 16 shtator.

Prokuroria e specializuar e akuzon Salih Mustafën për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, përkatësisht se ai ka nxitur ose urdhëruar akte kriminale të privimit arbitrar nga liria, trajtim mizor, torturë dhe vrasje.

Në ditën e parë të deklaratave përmbyllëse, Smith theksoi se gjykata duhet të fokusohet te viktimat.

"Tortura ka lënë efekte afatgjata si në psikikën, ashtu edhe në trupin e viktimave", theksoi Smith. Ai tha se qëllimi i këtyre torturave ka qenë identifikimi i shqiptarëve të

Kosovës që nuk e kanë përkrahur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Prokuroria e Specializuar pohoi se individët ende ndiejnë frikë të flasin lirshëm për torturat që kanë përjetuar, duke theksuar se këta persona nuk kanë qenë kurrë "armiqtë të Kosovës". "Viktimat janë etiketuar si bashkëpunëtorë dhe spiunë që punojnë për armikun, sepse nuk e kanë përkrahur mjaftueshëm UÇK-në, prandaj janë burgosur në një pronë në Zllash", tha prokurori Smith.

Në paraqitjen e tij të parë në Gjykatën Speciale në Hagë, Mustafa refuzoi të deklarohet për fajësinë.

### Për çfarë ngarkohet Mustafa?

Gjykimi i Salih Mustafës ka nisur më 15 shtator të vitit 2021 dhe ky është gjykimi i parë për krime lufte që ka nisur në Dhomat e Specializuara. Mustafa u arrestua më 24 shtator të vitit 2020 dhe është personi i parë i arrestuar kundër të cilit u konfirmua aktakuza prej që janë formuar Dhomat e Specializuara dhe Prokuroria e Specializuar në vitin 2015.

Pretendohet se Salih Mustafa, i njohur si komandant "Cali", ishte komandant i njësisë guerile Agjencia për Siguri dhe



Informacion, e cila i përkiste zonës operative të Llapit të UÇK-së.

Kjo njësi, në përbërjen e saj, kishte afërsisht 500-600 trupa, të cilat vepronin kryesisht në zonat e qytetit në Prishtinë dhe Obiliq, në rrethinat e tyre, si dhe në zonën e Gollakut, ku ndodhet fshati Zllash.

Gjithashtu, thuhet se veprat penale, për të cilat janë paraqitur akuzat, kanë ndodhur në kontekstin e "konfliktit të armatosur" dhe kanë qenë të ndërlidhura me konfliktin e armatosur në Kosovë, ndërmjet UÇK-së dhe forcave të Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ) dhe

Republikës së Serbisë, "përfshirë edhe njësitë e Ushtrisë së Jugosllavisë, njësitë e policisë dhe njësitë e tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe grupeve të tjera që luftonin në anën e RFJ-së dhe Serbisë".

Më tej, thuhet se në periudhën nga 1 prilli 1999 deri më 19 prill 1999 Salih Mustafa dhe anëtarët e tjerë të UÇK-së kanë mbajtur të mbyllur në një pronë në Zllash, të paktën gjashtë persona.

Gjithashtu, thuhet se gjatë prillit të vitit 1999, në atë vend, është vrarë një i burgosur.

Ndër të tjerë, shtohet se Mustafa "së bashku me anëtarët e tjerë të UÇK-së" e morën një person për ta marrë në pyetje, identiteti i të cilit ishte i fshehur, "dhe urdhëroi që ta rrihnin". Siç thuhet në aktakuzë, derisa po e rrihnin me mjete të ndryshme të forta, atij personi iu tha se është "spion dhe se do ta vrisnin". Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës në Hagë po heton krimet e pretenduara të anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të kryer kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë në periudhën nga janari 1998 deri në dhjetor 2000.



## AAK-ja kërkon të votohet Ligji për Pensionistët Kontributdhënës

Prishtinë, 13 shtator - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka kërkuar mbështetjen e deputetëve të pozitës për plotësim-ndryshimin e ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Deputeti Shemsedin Dreshaj, në konferencën për medie të martën, ka thënë se me këtë propozim parashihet të largohet neni diskriminues i këtij ligji i cili parasheh që çdo person të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune para vitit 1999 në mënyrë që ta përfitojë pensionin kontributdhënës.

Dreshaj ka njoftuar që kjo nismë do të hidhet në votim në seancën plenare të së enjtes, andaj ka kërkuar nga të gjithë deputetët ta mbështesin. “Me propozimin që ne kemi iniciuar, parashihet që pensionet kontributdhënës t’i gëzojnë të gjithë pensionistët varësisht nga vitet që kanë punuar para datës 1 janar 1999. Siç e dini, kemi raste kur për një ditë, dikush që nuk ka arritur t’i bëjë 15 vjet, nuk e gëzon pensionin e merituar. Ne besojmë se kjo iniciativë do të mbështetet edhe nga grupet e tjera parlamentare, e sidomos

edhe nga partia që ka shumicën në këtë kuvend. Kërkesë jonë është që të largohet ky kushtëzim jologjik, i dëmshëm dhe diskriminues për punëtorët të cilët në vitet '90 ishin larguar dhunshëm dhe jashtëligjshëm nga institucionet shtetërore të pushtetit të atëhershëm. Sa për informatë, kjo nismë legislative ka kaluar të gjithë hapat e domosdoshëm, madje edhe llogaritjen e kostos buxhetore. U kërkojmë mbështetje të gjithë kolegëve deputetë që t’i japin mbështetje këtij ligji”, ka përfunduar Dreshaj.



## Kosovë, ngrehe zërin!



**Shkruan: Sali BISLIMI**

Një pseudo mbi asnjë bazë ligjore të vlefshme për pranueshmërinë e saj, duke iu referuar dispozitave të neneve 17 deri në 19 të Statutit të Romës. Drejtësia është një rregull thelbësor procedural: “Të drejtën për gjykim të drejtë dhe jo për një procedurë të nisur në mënyrë të ngathët dhe pa respektim të rregullave të juridiksionit territorial”. Aktualisht jemi dëshmitarë të

një pseudogjykimi unik në botë, ku presidenti bën autogjykimin.

Kush e shantazhoi presidentin Thaçi kur u vu në dispozicion të magistratëve të Hagës? Si është e mundur që kjo gjykatë të furnizohet me të dhëna nga Serbia, të një Serbie që është e njohur për krime lufte, gjenocid, agresion dhe krime kundër njerëzimit. Gjykata Penale Ndërkombëtare bën gabimin më të madh në historinë e saj duke u marrë me Kosovën dhe jo me Serbinë fashiste dhe inicion

proces për apetitet serbo-ruse dhe do ta humbë padyshim kredibilitetin e saj.

Akuzat që ngarkohet presidenti Thaçi janë rrena të fabrikuara që nesër do të turpërohet edhe vetë gjykata. Turpin po e hani me bukë edhe ju patriotë dhe intelektualë që keni zgjedhur heshtjen. Kështu nuk ndërtohet as liria, as drejtësia, as demokracia. Mjerim! Kontestoni këtë pseudoproces dhe këtë të ashtuquajtur procedurë. Liri për presidentin!

## Kamberi përplaset me Vuçiqin për Kosovën

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Deputeti i vetëm shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, tha se Kosova është shtet i pavarur teksa në organin ligjvënës presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, prezantoi raportin për dialogun politik me Kosovën. “Çfarëdo që dëshironi të arrini atje, duhet të arrini në marrëveshje me autoritetet lokale dhe kushdo që është në pushtet atje, Serbia nuk ka ndikim”, tha Kamberi. Ai iu kundërpërgjigj deklaratave të Vuçiqit, i cili tha se për aq kohë sa ai të ketë ndikim, “Serbia nuk do ta njohë as drejtpërdrejt, as tërthorazi pavarësinë e njëanshme të Kosovës”.

Kamberi tha se serbët që jetojnë në Republikën e Kosovës kanë të drejta të shumta, të garantuara me

Kushtetutë dhe kanë përfaqësim në Kuvend dhe qeveri, ndërkaq këto të drejta nuk i ka minoriteti shqiptar dhe minoritetet e tjera që jetojnë në Serbi.

Deputeti Kamberi tha se një marrëveshje përfundimtare midis Kosovës dhe Serbisë është një ndër sfidat më të vështira dhe se është obligim i Vuçiqit ta udhëheqë Serbinë drejt zgjidhjeve që krijojnë perspektivë evropiane. Ai tha se përmirësimi i raporteve me “armikun e përjetshëm” kërkon aftësi për të kuptuar se “nuk ka pajtim pa u përballur me të kaluarën”.

Sipas Kamberit, Vuçiqi e ka përgjegjësinë më të madhe që t’u tregojë qytetarëve serbë për Kosovën “të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, e jo dëshirat boshë dhe ambiciet politike”. Ai, po ashtu, tha se



në Serbi ende nuk atmosferë që dikush t’u kërkojë falje shqiptarëve.

Duke iu përgjigjur deklaratave të Kamberit, Vuçiqi tha se Kosova nuk është shtet i pavarur dhe se serbët në veri të Kosovës nuk kanë status të njëjtë me shqiptarët që jetojnë në jug të Serbisë. “Ju po e

paraqisni situatën sikur Kosova është shtet i pavarur, se nuk ka asgjë të diskutueshme, por se bëhet fjalë vetëm për një marrëveshje dypalëshe që vendos barazi dhe identitet të të drejtave të serbëve dhe shqiptarëve në dy shtete të pavarura. Por, çështja nuk

është kështu”, tha Vuçiqi.

Vuçiqi i tha Kamberit se “nuk kam asgjë kundër” dënimit të krimeve që kanë ndodhur kundër shqiptarëve, por shtoi se pala tjetër “hesht dhe nuk po flet” për krimet, siç tha presidenti serb, të kryera nga ata. Vuçiqi, po ashtu, e pranoi se Kamberi ka të drejtë kur thotë se autoritetet nuk po investojnë mjaftueshëm në dy komuna në jug të Serbisë, që banohen nga shqiptarët - Preshevë dhe Bujanoc, por edhe në Medvegjë. Por, presidenti i Serbisë paralajmëroi se do të ketë më shumë investime në këto tri komuna, që njihen ndryshe edhe si Lugina e Preshevës. Në Kuvendin e Serbisë u prezantua raporti i qeverisë për dialogun e zhvilluar me Kosovën që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

## Komuna e Prishtinës hap tenderin për furnizim me mikroçipa për qentë endacakë

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Komuna e Prishtinës ka shpallur tenderin për furnizim me mikroçipa për qentë endacakë. Data e publikimit të tenderit është bërë më 8 shtator 2022 dhe do të jetë i hapur deri më 27 shtator 2022. Vlera e tenderit është 34 mijë euro. Për këtë kontratë, lloji i procedurës

është e hapur. Ndërkaq, kriteri i dhënies është me çmimin më të ulët. Sipas njoftimit, vlefshmëria e tenderit është për 60 ditë, kurse mikroçipat duhet të kenë origjinë nga BE-ja.

Komuna e Prishtinës, përkatësisht drejtori i Shërbimeve Publike në këtë komunë, Ilirik Musliu, kishte

thënë se do të bëjnë blerjen e çipave të cilët do t’u vendosen qenve endacakë, sipas tij, me qëllim që të identifikohen, ngaqë thotë se po vijnë qen edhe nga komunat e tjera. Po ashtu, ai shtoi se për trajtimin e qenve endacakë do të vihet në funksion edhe strehimorja regionale e cila do të jetë gati vitin tjetër.





## Ministri Krasniqi fillon vizitën zyrtare në Izrael

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, me ftesë të ministrit për Bashkëpunim Regjional të Izraelit, Esawi Frej, do të qëndrojë në një vizitë zyrtare në Izrael, ku do të realizojë takime me zyrtarë shtetërorë nga Izraeli për të diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në mes të dy shteteve.

Ministri Krasniqi vizitën zyrtare në Izrael e filloi duke u

pritur në takim nga ministri për Bashkëpunim Regjional, Esawi Frej. Gjatë këtij takimi, ministri Krasniqi dhe ministri Frej diskutuan për bashkëpunimin në mes të dy vendeve, për raportet e shkëlqyera në mes të Republikës së Kosovës dhe shtetit të Izraelit si dhe për mundësitë për thellimin e bashkëpunimit në fushën e zhvillimit ekonomik lokal dhe qeverisjes lokale.

Ministri Krasniqi e ka falënderuar ministrin Frej për ndihmën e shtetit të Izraelit dhënë për popullin e Kosovës duke shprehur mirënjohjen e thellë dhe gatishmërinë për t'i fuqizuar marrëdhëniet bilaterale.

Gjithashtu, në kuadër të kësaj vizite, ministri Krasniqi ka vizituar Qendrën Përkujtimore të Holokaustit në nderim të viktimave të gjenocidit famëkeq të shekullit XX.



## Gratë zotërojnë vetëm 17 për qind të pronës në Kosovë

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Profili Gjiner i Kosovës "Bujqësia dhe jetesa rurale", i përgatitur nga Rrjeti i Grave të Kosovës, me mbështetjen financiare të FAO-s, vë në pah pabarazitë gjinore që ndikojnë në aspekte të ndryshme të prodhimit bujqësor dhe jetesës rurale.

Vlerësimi thekson se gratë rurale shpenzojnë 83 për qind të kohës së tyre duke punuar në punë të paguar ose të papaguar, ndërsa burrat ruralë shpenzojnë vetëm 66 për qind të kohës. Gratë rurale shpenzojnë dy herë më shumë kohë se burrat me gatimin, pastrimin dhe kujdesin për fëmijët dhe të moshuarit.

Për shkak të përgjegjësisë shtëpiake, të cilat u atribuohen shoqërisht grave, ato kanë kohë më të kufizuar për punë të paguar, aktivitete bujqësore, arsimim, trajnim dhe angazhim në proceset lokale të vendimmarrjes. Rrjedhimisht, burrat përfaqësojnë familjet e tyre në proceset vendimmarrëse jashtë familjes.

Sipas studimit, gratë zotërojnë vetëm 17 për qind të pronës në Kosovë, gjë që kufizon qasjen e tyre në tokë, grante, subvencione dhe kredi. Më pak se 0.3 për qind e të gjitha ekonomive bujqësore janë të regjistruara si biznese. Nga të gjitha fermat gratë zotërojnë vetëm 4.9 për qind dhe përbëjnë 5.8 për qind të fermerëve të regjistruar.

Të dhënat e këtij studimi janë prezantuar në një punëtori konsultative me palët e interesit. Zëvendësministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Imri Demelezi, ka thënë se duke qenë e vetëdijshme se kushtet e jetesës në zonat rurale janë më të vështira, qeveria ka vendosur ta rrisë buxhetin për programet të cilat ndihmojnë dhe zhvillojnë bujqësinë dhe përmirësojnë cilësinë e jetës në zonat rurale, me fokus te gratë dhe të rinjtë.

Ai ka bërë me dije se në Strategjinë dhe Programin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2022-2028 është bërë një përmirësim me masa afirmative për përkrahje të grave. "MBPZHR është duke punuar edhe në Ligjin për Faturat Bujqësore dhe të

Magazinave, ku fermerëve u mundësohet qasje më e lehtë në financa, e këtui sidomos për gratë mund të krijohet qasje më e lehtë, duke e ditur se ato kanë më shumë probleme në qasje në financa", ka theksuar zëvendësministri Demelezi.

Sipas Anna Jenderedijian, specialiste për mbrojtjen gjinore dhe sociale në FAO, qëllimi kryesor i analizës së bërë është identifikimi i boshllëqeve kryesore gjinore si dhe për ta identifikuar mbështetjen e mundshme teknike të FAO-s në të ardhmen për sektorin.

Nicole Farnsworth, drejtoreshë e Programit dhe Udhëheqëse e Hulumentit nga Rrjeti i Grave të Kosovës, ka theksuar se Profili Gjiner i Kosovës "Bujqësia dhe

jetesa rurale" propozon rekomandime të bazuara në prova për avancimin e barazisë gjinore dhe fuqizimit ekonomik të grave në bujqësi dhe zhvillim rural, duke përfshirë strategji digjitale gjithëpërfshirëse. "Rekomandimet synojnë të informojnë disa strategji dhe programe që po hartohen në Kosovë, për të siguruar që ato të jenë të informuara nga analiza gjinore. Ne si RrGK shpresojmë që rekomandimet tona të merren parasysh dhe të adresohen nga institucionet përkatëse", ka deklaruar Farnsworth, duke shprehur gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me MBPZHR-në dhe institucionet e tjera për zbatimin e rekomandimeve dhe për një shoqëri më të barabartë.

## Caktohen koordinatorët për veprat penale kundër integritetit seksual

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Me kërkesë të ushtruesit të detyrës të Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, kryeprokurorët e të gjitha prokurorive të vendit kanë

caktuar koordinatorët për veprat penale kundër integritetit seksual. Gjithashtu, koordinator përgjegjës për të gjitha prokuroritë është caktuar një

prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. Qëllimi i caktimit të koordinatorëve është që këto raste të trajtohen me prioritet të shtuar gjatë punës së

institucionit të Prokurorit të Shtetit, rrjedhimisht të koordinohet puna për trajtimin sa më efikas të këtyre rasteve në të gjitha fazat e procedurës penale.





## Rafuna interesohet për investime nga Tajvani në Kosovë

**PRISHTINË 13 SHTATOR** - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka pritur në takim një delegacion nga zyra përfaqësuese e Taipeiit në Hungari, me të cilët ka diskutuar për mundësitë për investime nga Tajvani në Kosovë. Rafuna ka theksuar se të dyja palët duhet t'i zgjerojnë kontaktet ekzistuese dhe të vendosin marrëdhënie të mira biznesore në mes të dy vendeve

në mënyrë që të promovohen mundësitë e investimit në sektorë potencialë. "Kosova ofron mundësi të favorshme për investime", u shpreh Rafuna, duke theksuar se përparësitë e Kosovës ofrojnë mundësi për përfitime për investitorët nga e tërë bota. Palët u morën vesh të shkëmbejnë informacione rreth hulumtimit të tregut për t'i identifikuar mundësitë e

bashkëpunimit ndërbiznesor; të organizohen misione tregtare si dhe pjesëmarrje reciproke në panairë të organizuara nga të dyja vendet. Rafuna, gjithashtu, ka propozuar që, përveç takimeve B2B, të organizohen edhe takimet G2G, të cilët mundësojnë diskutimin dhe tejkalimin më të lehtë të barrierave biznesore për investime në vendin tonë.



## Bizneset të njoftohen për rëndësinë e arbitrazhit si mekanizëm alternativ për zgjidhje të kontesteve



**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 13 SHTATOR** - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, në bashkëpunim me Programin për Drejtësi Komeriale i USAID-it, organizuan një tryezë të rrumbullakët me gjyqtarë, avokatë dhe arbitra, me qëllim të shkëmbimit të informatave lidhur me zgjidhjet alternative të kontesteve me fokus në arbitrazh.

Chris Thompson, shef i Partisë për Programin e Drejtësisë Komeriale të USAID-it, pohoi se pavarësisht mundësisë së mrekullueshme për ta

shmangur bllokimin në çështjet gjyqësore, arbitrazhi nuk po përdoret sa duhet. Më tej, ai ka theksuar se USAID-i mbështet shumë gjëra, ndër të tjera, ofron mbështetje në ndërtimin e arbitrazhit dhe shfrytëzimin e arbitrazhit në Kosovë duke pasur parasysh mundësinë e madhe që ka. Thompson ka theksuar se është e rëndësishme që avokatët të pranojnë se duhet ta vendosin klauzolën e arbitrazhit në kontratën e tyre. Arian Zeka, drejtor ekzekutiv në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë, ka thënë se krahas promovimit të përfitimeve të

arbitrazhit, është e rëndësishme të ketë diskutime që identifikojnë barrierat që çojnë në një numër kaq të vogël të rasteve të arbitrazhit. Ai ka theksuar se avokatët kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e arbitrazhit dhe ndërmjetësimin si mekanizma për zgjidhjen e kontesteve. Mahir Tutuli, kryetar i Gjykatës Ekonomike, tha se që nga themelimi i Gjykatës Komeriale ka pasur vetëm disa raste arbitrazhi. Ai ka thënë se sfidat kryesore që hasen në arbitrazh janë procedurat e përbarimit, të cilat ndonjëherë zgjasin edhe më shumë sesa të shkosh në

gjykatë. Së fundi, ai ka pohuar se është e rëndësishme që të gjithë mekanizmat institucionalë të fokusohen në gjetjen e një zgjidhjeje për këtë çështje dhe t'i lehtësojnë procedurat e gjykatave tashmë të stërmbushura me lëndë. Verona Dibra, gjyqtare në Gjykatën Komeriale, ka thënë se janë vetëm dy çështje arbitrazhi. Procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kërkon kohë, kalon nëpër faza të ndryshme, por zakonisht ajo që e pengon përpunimin e saj është pjesa e ekzekutimit, e cila kërkon një qasje të duhur. Skender Gojani, avokat në Odën e Avokatëve, ka thënë se

ka nevojë për një promovim më të mirë të arbitrazhit, sidomos në drejtim të promovimit në sektorin privat, përkatësisht bizneset. Kjo do të ishte bërë e mundur nëpërmjet përmirësimit të listave të arbitrazhit dhe promovimit të tyre. Njomëza Zejnullahu, Arbitre dhe zyrtare e lartë ligjore, Programi për Drejtësi Komeriale të USAID-it, ka thënë se qëllimi i kësaj tryeze ishte nxitja e bashkëpunimit ndërinstitucional, në veçanti për të diskutuar me njëri-tjetrin se cilat janë pengesat e arbitrazhit dhe si t'i trajtojmë ato.

## Murati flet për humbjet në Trust: Ka luhatje të çmimeve në bursat ndërkombëtare

**PRISHTINË, 13 SHTATOR** - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka pranuar se Fondi i Kursimeve Pensionale (Trusti) është duke pësuar humbje financiare. Murati në një konferencë për medie ka thënë të martën se në bursat ndërkombëtare ka luhatje të çmimeve për shkak të krizës në tregjet ndërkombëtare. Megjithatë, ai tha se të rinjë do t'u rikuperojnë humbjet

dhe shpreson se ata që janë në prag të pensionimit nuk do të preken nga këto rënie të investimeve. "Duhet të sqarohet që në rastet kur ka investime në bursat ndërkombëtare ka luhatje të çmimeve, të cilat janë luhatje të përkohshme dhe lëvizin. Ideja e investimeve afatgjatë të fondeve të tilla në aksione të ndryshme apo fonde efektive është që të sigurohet një kthim mesatar në afatgjatë,

sepse dikush që është i moshës 30-vjeçare që kontribuon sot, pra nuk pret që t'i marrë këtë vit apo vitin e ardhshëm mjetet. Ideja është si investim afatgjatë, në horizonte afatgjatë mbi 30 vjeç, 40 vjeç që në momentin kur dilet në pension të sigurohet një pension i dinjitetshëm për shkak se ka pasur një kthim mesatar 7 apo 8 për qind vjetor", ka thënë Murati.





# Arsyeja e vërtetë pse fëmijëve nuk u pëlqen shkolla



Nga Arthur C. BROOKS

Që i vogël, por edhe më vonë kur isha më i rritur, e urreja të vajturin në shkollë. Nuk më kujtohet ndonjëherë që të kem dashur të qëndroj me dëshirë në klasë, qëkur kam nisur kopshtin, dhe deri kur e braktisa universitetin pasi përfundova vitin e parë. Braktisja e universitetit për mua ishte njësoj si të merrja faljen e dënimit nga guvernatori. Sigurisht që kjo nuk më bën të veçantë, pasi në shkollë ka kaq shumë fëmijë të pakënaqur. Shkolla është padyshim një gjë e mirë për shumicën e fëmijëve. Por nëse vajza juaj nuk ka një pasion të çuditshëm në shkencat sociale, është e kotë t'i thoni asaj se "arsimi e stimulon mirëqenien subjektive në një periudhë afatgjatë".

Ajo që e shkatëron atë përvojë për kaq shumë fëmijë, siç ka ndodhur me mua, është fakti që shkolla është sot një vend ku ndihesh i vetmuar dhe i mërziur. Duke shqyrtuar studimet mbi të mësuarit dhe lumturinë, ne zbulojmë se ndjenjat e fëmijëve ndaj shkollës, nuk kanë të bëjnë aq shumë me moshën, përkatësinë etnike apo prejardhjen socio-ekonomike, por me dy faktorë bazë: miqësinë dhe interesin. Fatmirësisht, duke ditur pak nga të dyja, ne mund të përmirësojmë jetën e të gjithë nxënësve që kohët e fundit janë rikthyer në shkollë të tronditur ose duke u dridhur nga mendimi se duhet ta bëjnë këtë edhe në ditët në vijim. Kur është fjala për mirëqenien afatgjatë, ekzistojnë pak shpikje që e risin lumturinë më shumë sesa arsimit.

Duke përdorur të dhëna nga të rriturit nga 85 vende, studiuesi austriak Erik Striesnig zbuloi në vitin 2015, se njerëzit që kishin përfunduar arsimin e mesëm kishin 10 për qind më shumë gjasa të raportonin se ishin të lumtur, sesa ata që nuk e kishin përfunduar arsimin e mesëm, edhe duke qenë me të ardhura të përafërta.

Ndërkohë ata që përfundonin shkollën e lartë, kishin 30 për qind gjasa që të ishin më të lumtur. Një shpjegim i mundshëm për këto përfundime, është se mësimi stimulon një emocion të fuqishëm pozitiv: interesin. Kerol Izard, studiuese në fushën e emocioneve, e përkufizon interesin si "motivimin kryesor që qëndron pas përfshirjes në veprimtari krijuese dhe konstruktive dhe ndjenjës së mirëqenies".

Thënë thjesht, ekspozimi i njerëzve ndaj ideve dhe mjeteve që u ofrojnë njohuri, u jep atyre edhe mekanizmat për të prodhuar lumturi gjatë gjithë jetës. Prandaj, nuk është për t'u habitur që leximi, të cilin të rriturit përpiqen që t'ua kultivojnë si pasion fëmijëve të tyre, është zbuluar se rrit kënaqësinë e jetës.

Gjithsesi, sjelljet e fëmijëve kur janë në shkollë, nuk reflektojnë përfitimet e mëdha që do të kenë më vonë në aspektin e lumturisë. Sipas një studimi të kryer vitin e kaluar me mbi 21.000 nxënës të shkollave të mesme në Shtetet e Bashkuara, dy ndjenjat më të zakonshme të përjetuara në shkollë janë stresi (79.8 për qind) dhe mërzia (69.5 për qind). Disa shprehën emocione pozitive

si krenaria dhe gëzimi. Por në përgjithësi gati 75 për qind e ndjenjave të deklaruara spontanisht për shkollën ishin negative. Do të ishte e lehtë që ky studim të shpërfilllej, duke e interpretuar atë si një version të dilemës së "Gjinkallës dhe Milingonës", sipas së cilës një përpjekje që është e mërziutshme për momentin, çon në rezultate shumë pozitive në të ardhmen.

Por unë mendoj se ai është shumë realist. Për shumë fëmijë, shkolla nuk është vetëm e lodhshme, por edhe shumë e vetmuar. Studimet tregojnë se 80 për qind e fëmijëve ndihen ndonjëherë të vetmuar në shkollë.

Ky emocion lidhet me mërzinë, pasivitetin, tendencën për t'u strehuar tek fantazitë dhe qëndrimin pasiv ndaj ndërveprimeve shoqërore. Të thuash që vetmia mund të të shtypë çdo interes ndaj shkollës, nuk është një ekzagjerim. Anasjelltas, miqësia në shkollë është treguesi kryesor i kënaqësisë dhe sjelljes pozitive.

Instituti Gallup zbuloi se të pasurit e një shoku apo shoqeje në shkollë është treguesi më i mirë i bashkëveprimit në klasë, si për nxënësit e klasës së pestë ashtu edhe ata të klasës së tretë. Në mënyrë të ngjashme, hulumtimet nga Universiteti Hebraik i Jeruzalemit, Universiteti i Warwick dhe Byroja Kombëtare e Kërkimeve Ekonomike tregojnë se studentët që kanë një miqësi të ndërsjellë, në të cilën të dy personat e përfshirë e perceptojnë marrëdhënien në mënyrë të barabartë, kanë më shumë gjasa ta duan shkollën dhe të jenë më të

suksesshëm në klasë.

Në fakt gjithmonë ka ekzistuar një ndjesi e cila e nxit vetminë në shkollë. Sipas Qendrës Kombëtare për Statistikat e Arsimit, 20.2 për qind e studentëve amerikanë midis moshës 12 dhe 18 vjeç kanë pranuar se kanë qenë viktima të bullizmit.

Shumë studime kërkimore kanë nxjerrë në pah një lidhje të fortë mes bullizmit të zakonshëm dhe atij kibernetik, me ankthin dhe depresionin shoqëror. Bullizmi gjithashtu mund të sjellë probleme në mbarëvajtjenqë fëmijët mund të kenë në shkollë, dhe dëshirën e tyre për të pasur rezultate më të mira, si dhe mos pjesëmarrjen në mësim.

Një sondazh i vitit 2020 i kryer nga "Common sense media" zbuloi se 42 për qind e adoleshentëve ndiheshin "më të vetmuar se zakonisht". I njëjti studim tregoi se gati një në katër adoleshentë (24 për qind) pranonin se i kontaktonin mësuesit më pak se një herë në javë. Nëse ne duam që t'i ndihmojmë fëmijët të marrin lumturi nga edukimi në planin afat shkurtër dhe atë afat gjatë, duhet të investojmë në më shumë burime që e lehtësojnë krijimin e miqësive, të cilat e largojnë vetminë dhe mërzinë. Ka shumë kërkime dhe burime praktike që mund ta bëjnë më të thjeshtë pasjen e më shumë miqve për studentët.

Studimet tregojnë se programet për të parandaluar bullizmin në shkollë mund ta zvogëlojnë problemin me rreth 20 për qind. Të rriturit nuk duhet të qëndrojnë pasivë, duke shpresuar se problemi do të zgjidhet vetvetiu. Në bazë të të gjitha ndërhyrjeve

efikase qëndron të qenit të ndërgjegjshëm se problemi ekziston, dhe se duhet ndërhyrë menjëherë për ta zgjidhur atë.

Gjithashtu edhe studentët kanë nevojë për të pasur më shumë mundësi për të krijuar miqësi. Studimet tregojnë se, kur bëhet fjalë për vetminë dhe mirëqenien, ndërveprimet shoqërore të largëta janë dramatikisht të papërshtatshme për të zëvendësuar ato në pranë. Nëse të rriturit nuk gjejnë një mënyrë për t'i mbajtur shkollat hapur ndërkohë që vazhdojmë të luftojmë me pandeminë, vuajtjet e fëmijëve do të përkeqësohen (siç tregon edhe kolegu im Joshua D. Coval në hulumtimin e tij, ku në shumicën e rasteve rihapja e shkollave pengohet më shumë për arsye politike se sa për arsye shëndetësore).

Të bërit miq mund të jetë sfidë në çdo moshë. Studime e fundit që përdorin metoda të reja të bazuara në inteligjencën artificiale ofrojnë këshilla të dobishme për fëmijët (dhe të rriturit) që duan të kenë më shumë informacione.

Të dhënat tregojnë se vlerësimi shoqëror (vënia në dukje dhe të vënit e theksit tek ajo që njerëzit pozitivisht bëjnë), si dhe imitimi (për shembull të qeshurit bashkë me të tjerët) janë mënyra të shkëlqyera për të nisur një miqësi. Duke pasur më shumë miq, studentët do të ndjehen më të gëzuar dhe të interesuar, dhe pakënaqësitë e tyre do t'i kthejnë në një bezdi të vogël. Kështu të gjithë do të jenë më të përgatitur për të mirëpritur përfitimet afatgjata që arsimimi sjell për sa i përket lumturisë.

! "The Atlantic" – Bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Sot derbi Drita - Gjilani

Drita është përgatitur për ta fituar ndeshjen derbi ndaj rivalit lokal, Gjilanit. Trajneri Ardian Nuhiu ka thënë se kjo do të jetë një ndeshje speciale dhe se detyrë e skuadrës së tij është të tregojë karakter dhe t'i marrë tri pikë. Gjilani është në pozitën e parë në renditjen tabelore me 14 pikë, kurse Drita në vendin e dytë me 11 pikë, por me një ndeshje më pak të zhvilluar

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 13 SHTATOR** - Derbi më i madh në futbollin e Kosovës zhvillohet sot në mes të Dritës dhe Gjilanit. Këto dy skuadra e kryesojnë Superligën dhe interesimi për këtë ndeshje është i jashtëzakonshëm. Trajneri i Dritës, Ardian Nuhiu, në konferencë për medie një ditë para ndeshjes ka thënë se kjo do të jetë një ndeshje speciale dhe se detyrë e skuadrës së tij është të tregojë karakter. "Na pret një ndeshje speciale për ne dhe tifozët tanë, të cilën duhet ta luajmë me

përqendrim dhe përgjegjësi. Skuadrën kundërshtare e njohim mirë, ka cilësi dhe ecuri të mirë. Më gëzon forma e mirë e skuadrës sonë. Përveç në aspektin ekipor dhe në atë individual, të gjithë futbollistët dalëngadalë po marrin formën e tyre optimale. Secili po e njeh bashkëlojtarin dhe po përformojmë jashtëzakonisht mirë. Na mbetet të bëjmë një ndeshje të madhe dhe të shfrytëzojmë potencialin tonë të dalim sa më mirë nga kjo ndeshje", ka thënë Nuhiu. "Gjithmonë kjo ndeshje është motiv shtesë, pavarësisht se në ndeshjet e fundit derbi nuk i kemi fituar. Në ndeshje



të tilla ato pak raste duhen shfrytëzuar, sepse përkundër mundësive të krijuara, ndonjëherë thjesht ka munguar finalizimi. Uroj ta kemi edhe fatin sportiv për t'i marrë tri pikë. I dua ndeshjet e forta, sepse futbollistët i kam të tillë, të cilët janë rritur në vështirësi dhe në sfida tregohet karakteri i futbollistit", ka shtuar Nuhiu.

Ndërsa mbrojtësi Besnik Krasniqi ka theksuar se do të luftojnë që ta fitojnë këtë ndeshje për tifozët. "Është një ndeshje shumë e fortë mes dy ekipeve që po kalojnë formë të mirë. Jemi të përgatitur për këtë ndeshje edhe pse ishte kohë shumë e shkurtër. Ne e dimë rëndësinë e derbit dhe jemi të motivuar ta fitojmë këtë ndeshje jo

**SUPERLIGA - Java 7**

**Të mërkurën takohen:**  
15:00 Drita - Gjilani  
15:00 Prishtina - Malisheva

**Të enjten takohen:**  
15:00 Dukagjini - Drenica  
15:00 Trepça '89 - Ferizaj  
15:00 Llapi - Ballkani (Është shtyrë)

vetëm për ne, por edhe për gjithë qytetin dhe tifozët e Dritës. Është një ndeshje që nuk bën të humbet. Na mbetet ta japim maksimumin e të luftojmë për veten dhe shikuesit të cilët e meritojnë fitoren", ka thënë Krasniqi. Sot zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Prishtinës dhe Malishevës. Dy ndeshje të tjera të kësaj xhiroje zhvillohen nesër (e enjte), ndërsa derbi Llapi - Ballkani është shtyrë.

## City kërkon fitoren e dytë ndaj Dortmundit

"Epoka e re"

**MANCHESTER, 13 SHTATOR** - Manchester City dhe Borussia Dortmundi do të tentojnë të dy të vazhdojnë me fitore në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve. Këto dy klube e ndajnë mejdantin sonte (e mërkurë) në kuadër të Grupit G në stadiumin "Etihad". Skuadra e Pep Guardiolës fitoi 4-0 ndaj Sevilas në ndeshjen e parë, kurse Dortmundi e mposhti Kopenhagën me rezultat 3-0. City e ka nisur mirë edicionin e ri në Premierë Ligë, por synim i kësaj skuadre do të jetë Liga e Kampionëve. Kjo ndeshje është e veçantë për sulmuesin Erling Haaland dhe mbrojtësin Manuel Akanji, të cilët do të përballen ndaj ish-skuadrës së tyre. Forma e norvegjezitet në ndeshjet e para me fanellën e Cityt e ka bërë gjigantin anglez skuadër edhe më të rezikshme. Në anën tjetër Dortmundi do të përpiqet ta marrë maksimumin nga kjo ndeshje edhe përkundër asaj se në ndeshjen e fundit në Bundesliga ka pësuar humbje. Ndeshje interesante do të zhvillohen edhe në Grupin E, Milani dhe Chelsea do të kërkojnë



**Formacionet e mundshme:**

**Manchester City:** Ederson; Cancelo, Dias, Akanji, Gomez; Silva, Rodri, De Bruyne; Foden, Haaland, Grealish.

**Borussia Dortmund:** Meyer; Meunier, Sule, Schlotterbeck, Guerreiro; Ozcan, Bellingham; Brandt, Reus, Reyna; Modeste.

fitoret e para në këtë edicion garash. Chelsea pësoi humbje nga Dinamo Zagrebi në ndeshjen e parë, kurse Milani barazoi me Salzburgun. Kampioni në fuqi, Real Madrid, pas fitores në ndeshjen e parë kundër Celticut, kërkon fitoren e dytë, por kësaj radhe ndaj Leipzigut. Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, në prag të

përballjes në "Santiago Bernabeu" ndaj Leipzigut, ka thënë se skuadra e tij është e gatshme për ta fituar ndeshjen ndaj një kundërshtari të vështirë. "Është një ndeshje e rëndësishme për klasifikimin e grupit. Është një skuadër që ka pasur probleme në fillim të sezonit, por luajti shumë mirë në ndeshjen e fundit kundër Dortmundit. Ka lojtarë me cilësi,



**GRUPI A**

21:00 Rangers - Napoli

Tabela	
1. Ajaxi	3 pikë
2. Napoli	3
3. Liverpooli	0
4. Rangers	0

**GRUPI E**

18:45 Milan - Dinamo Zagreb  
21:00 Chelsea - Salzburg

Tabela	
1. Dinamo Zagreb	3 pikë
2. Milan	1
3. Salzburg	1
4. Chelsea	0

**GRUPI F**

18:45 Shakhtar Donetsk - Celtic  
21:00 Real Madrid - Leipzig

**Tabela**

1. Shakhtar Donetsk	3 pikë
2. Real Madrid	3
3. Leipzig	0
4. Celtic	0

**GRUPI G**

21:00 Copenhagen - Sevilla  
21:00 Manchester City - Borussia Dortmund

**Tabela**

1. Manchester City	3 pikë
2. Borussia Dortmund	3
3. Copenhagen	0
4. Sevilla	0

**GRUPI H**

21:00 Juventus - Benfica  
21:00 Maccabi Haifa - Paris Saint-Germain

**Tabela**

1. Benfica	3 pikë
2. PSG	3
3. Juventus	0
4. Maccabi Haifa	0

afësi dhe shumë të shpejtë. Duhet ta vlerësojmë që të përgatitemi për

ndeshjen dhe të përpiqemi ta fitojmë", ka thënë Ancelotti.

## Kastrati ndan drejtësinë në ndeshjen e Ligës së Konferencës, Gent - Shamrock Rovers

**PRISHTINË, 13 SHTATOR** - Sektori i gjyqtarëve në FFK dhe puna profesionale e gjyqtarëve edhe një herë mori vlerësim të lartë nga UEFA për faktin se në

raundin e dytë të fazës së grupeve të Ligës së Konferencës, UEFA e ka caktuar gjyqtarin Visar Kastrati për ta drejtuar ndeshjen e

Grupit F ndërmjet Gentit dhe Shamrock Roversit. Kjo ndeshje zhvillohet në stadiumin e Gentit, të enjten, më 15 shtator, me fillim nga

ora 18:45. Gjyqtari Kastrati do të asistohet nga Besnik Morina dhe Granit Hyseni, ndërsa gjyqtar i katërt do të jetë Genc Nuza.





## Curry: Nëse largohem nga Golden State shkoj te Charlotte

SAN FRANCISCO, 13 SHTATOR - Basketbollisti Stephen Curry ka deklaruar se në rast se do të largohet nga ekipi i Golden State Warriorsit do të luante me skuadrën e Charlotte Hornetsit. "Nuk kam ndër mend të

largohem nga Golden State dhe këtu dua ta mbyll karrierën time", ka thënë Curry, kampion në fuqi në NBA. "Nuk e mohoj që skuadra tjetër ku do të dëshiroja të luaja përveç Warriors është Charlotte.

Gjithsesi, shanset që kjo gjë të ndodhë janë thujse zero, pasi këtu më duan dhe do të luaj ende për shumë kohë", ka shtuar Curry, që ka jetuar në Charlotte, qytet që e njeh mirë. Stephen Curry ka luajtur në

NBA vetëm me skuadrën e Golden States, që kur u përzgjedh në "draft" në vitin 2009. Katër herë kampioni i NBA-s është rekordmeni i guajtjeve për tri pikë. Ai ka kryer shkollën e mesme në Charlotte.



## IOC paraqiti modelin e kualifikimit të boksit për LO 'Paris 2024'

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) ka paraqitur modelin e kualifikimit për sportin e boksit për Lojërat Olimpike "Paris 2024" të miratuara javën e kaluar nga Bordi Ekzekutiv i IOC. Garat kualifikuese nuk do të zhvillohen nën përkujdesjen e Asociacionit Ndërkombëtar të Boksit (IBA) për shkak të suspendimit nga IOC. Garat do të organizohen nga IOC në bashkëpunim me Komitetet Olimpik Kombëtare, njësoj siç kishte ndodhur me garat kualifikuese për LO "Tokio 2020". Sistemi kualifikues bazohet në kualifikim të drejtpërdrejtë përmes garave të përzgjedhura, duke përfshirë garat shumëportëshe kontinentale dhe turneun kualifikues olimpik. Kështu, pesë garat multisportëshe që vlejnë për kualifikim janë: Lojërat Pan-Amerikane "Santiago 2023", Lojërat Evropiane "Krakovia 2023", Lojërat Pacifike "Honiara 2023", Lojërat Aziatike "Hanzhou 2023" dhe Lojërat Afrikane. Pas përfundimit të Lojërave shumëportëshe



kontinentale, IOC ka planifikuar mbajtjen e dy turneve botërorë kualifikues, të cilët do të organizohen gjatë vitit 2024. BE i IOC bëri me dije se i ka dërguar edhe një letër IBA-s, duke e informuar në lidhje me shqetësimet e IOC-të. Boksi aktualisht nuk është përfshirë ende në programin e Lojërave Olimpikë Los Anxhelos 2028 për shkak të

mungesës së reformave në këtë sport. Normën olimpikë "Paris 2024" do ta ndjekin edhe boksierët e Kosovës, ndërsa tre prej tyre Donjeta Sadiku, medaliste e bronzitë e botës 2022, Shpejtim Bajoku, medalist i bronzitë në Lojërat Mesdhetare "Oran 2022" dhe Patriot Behrami, marrin bursa olimpikë nga KOK-u përmes fondit të Solidaritetit Olimpik.

## Ademi në Gjakovë: Ndhimmojeni Vëllaznimin

GJAKOVË, 13 SHTATOR - Kryetari i FFK-së, Agim Ademi, bashkë me anëtarin e Komitetit Ekzekutiv, Agim Nura, e kanë vizituar KF Vëllaznimi në Gjakovë, ku u pritën nga drejtori i këtij klubi, Besnik Gojani. Në këtë vizitë u diskutua për situatën e vështirë dhe aspak të këndshme nëpër të cilën po kalon KF Vëllaznimi dhe të ardhmen e tij, e ku së shpejti do ta shënojë 100-vjetorin e themelimit. "Kryetari Ademi shprehu gatishmërinë për t'i ndihmuar këto klube në këtë drejtim dhe në varësi të kompetencave pasi që, siç dihet, KF Vëllaznimi dhe klubet e tjera në Kosovë kanë përkujdesje në nivel komunal dhe FFK do t'i përkrahë dhe do t'u qëndrojë afër me aq hapësirë dhe mundësi sa ka", thuhet në njoftimin e FFK-së. Kryetari i FFK-së i bëri thirrje komunës së Gjakovës si dhe komunitetit të sportit atje që ta



ndihmojnë KF Vëllaznimi, për organizim sa më të mirë, ngaqë një klub me histori të madhe në futbollin kosovar nuk e meriton ta përjetojë këtë gjendje në të cilën

ndodhet tash e një kohë. Po ashtu, Ademi vizitoi edhe Lidhjen Rajonale të Gjakovës, me ç'rast u informua nga afër me mbarëvajtjen e aktiviteteve atje.

### SHKURT

#### Trepça '89 paraqet mesfushorin afrikan

Mesfushori afrikan Abdulah Oyekanmi është futbollisti më i ri i cili bëhet pjesë e Trepçës '89. Abu është 19-vjeçar dhe vjen si përforsim në repartin e mesfushës të ekipit. "Nigeriani ishte pjesë e formacionit startues në ndeshjen ndaj KF Drenicës ku pat një paraqitje shumë të mirë. Abusi i urojmë shumë suksese në fanellën gjelbërebardhë!", ka shkruar KF Trepça '89.

#### Joshua dhe Fury përballen më 3 dhjetor

Superdueli mes Anthony Joshuas dhe Tyson Furyt do të zhvillohet më 3 dhjetor. Fury e lëshoi sfidën ndaj rivalit të tij javën e kaluar dhe i dha Joshuas dy data për të zgjedhur: 26 nëntorin, në stadiumin Wembley, ose 3 dhjetorin, në stadiumin "Principality" të Cardiffit. Joshua e ka pranuar të dytën. "Mund të konfirmojmë, në emër të Anthony Joshuas, se i pranuar të gjitha kushtet e paraqitura nga ekipi i Furyt për një përballje më 3 dhjetor të premten e kaluar", postoi 258 MGT në "Twitter", të martën në mëngjes. Fury dhe Joshua do të përplaseshin vitin e kaluar, por një panel arbitrazhi vendosi që Fury duhej të përballlej me Deontay Wilderin për të tretën herë.

#### PSG-ja e sheh Oblakun zëvendësues të Donnarummas

Klubi francez i PSG-së është duke menduar të transferojë një portier. Me Donnarumma titullar absolut dhe Navas i destinuar për t'u larguar, PSG-ja tashmë po mendon për një zëvendësues të portierit italian. Parisienët kanë si objektiv Jan Oblak të Atletico Madridit për sezonin e ardhshëm. Al Khelaifi do të tentojë portierin e klubit spanjoll në merkaton e verës, raporton "Media Foot".

#### Pensionohet Arda Turan

Arda Turan i ka dhënë fund karrierës prej futbollisti aktiv. Ikona turke e futbollit, Arda Turan, ka njoftuar për vendimin e tij që të pensionohet nga futbollit. Ish-mesfushori i Barcelonës dhe Atletico Madridit, si dhe ish-reprezentues i Turqisë, Turan, në moshën 35-vjeçare ndërpreu aktivitetin në futboll. Lojtari ishte pa skuadër që kur kontrata e tij me Galatasarayn skadoi në fund të sezonit të kaluar. "Ka qenë rrugëtim i shkëlqyer për mua, nënën time, babanë, vëllanë, gruan e fëmijët. Shpresoj që edhe për ju të tjerët. Ishte e vështirë, por e bukur", ka thënë Turan.

## Kane e pëlqen kalimin te Bayerni

Sulmuesi anglez Harry Kane do të jetë objektivi kryesor i klubit gjerman për sezonin e ardhshëm nëse merret një vendim përfundimtar për të blerë qendërsulmues, sipas

gazetarit nga "Sky Sport Deutschland", Florian Plettenberg. Diskutimet për këtë çështje thuhet se janë duke u zhvilluar, por që Bayerni për momentin nuk ka vendosur

nëse ka nevojë për një sulmues tipik. "Bavarezët" kanë kontaktuar me vëllanë e lojtarit, Charlie, i cili është edhe agjenti i sulmuesit të Tottenham Hotspurit. Është raportuar se klubi e ka

informuar atë për gatishmërinë për të bërë një ofertë për transferimin e 29-vjeçarit në rast se ai nuk rinovon kontratën me klubin nga Londra. Në anën tjetër, edhe kapiteni i

Kombëtares së Anglisë thuhet se nuk është kundër një lëvizjeje të mundshme drejt "Allianz Arena". Harry Kane ka kontratë të vlefshme me Tottenhamin deri më 30 qershor 2024.





Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

## NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Një (1) Punëtor Fizik - KRM "Uniteti" Sh.A Njësia në Skenderaj - i Konkursit të rishpallur me datë 24.08.2022

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej dates **14.09.2022**. deri me datë **20.09.2022** ora 16:00.

**Vërejtje:** Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

## NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Një (1) Vozitës të kategorisë "C" – KRM "Uniteti" Sh.A Njësia në Vushtri - i Konkursit të rishpallur me datë 24.08.2022

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej dates **14.09.2022**. deri me date **20.09.2022** ora 16:00.

**Vërejtje:** Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

## NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Një (1) Vozitës të kategorisë "C" - KRM "Uniteti"Sh.A Njësia në Skenderaj - i Konkursit të rishpallur me datë 24.08.2022

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej dates **14.09.2022**. deri me datë **20.09.2022** ora 16:00.

**Vërejtje:** Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

## NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Tre (3) Punëtor Fizik - KRM "Uniteti" Sh.A Njësia në Vushtri - i Konkursit të rishpallur me datë 24.08.2022

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej dates **14.09.2022**. deri me datë **20.09.2022** ora 16:00.

**Vërejtje:** Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Gjeje PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejepuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejepuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553  
PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Benita Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Andi Kameri, shpall të pavlefshme diplomën e lëshuar në vitin 2016 nga shkolla e mesme "Ismail Dumoshi", Obiliq.

- Emin Kasami shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Medina Alija shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Ekrem Rexha " Lubizhde.

- Burim Sallauka shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Meli Boshnjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- "Fokus Rent" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811871674.

- Marigona Kelmendi shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik, drejtimi Menaxhment dhe Informatikë në UP.

- Diellza Taturi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: X, XI, XII, si dhe diplomën e SH.M.F. "Gjon Nikollë Kazazi", drejtimi – Administrim Biznesi.

- Ari Mamusha shpall të pavlefshme dëftesën e klasës: X, XI, XII dhe diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Selim Sahatqija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## PASHTETË PULE

gluten  
free

MEKA  
HALAL FOOD

100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues